



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0692

Paneli Shqyrtues, i caktuar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga panelisti individual Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së OE Tretrek SH.P.K.: Botek SH.P.K. kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sistemi i Arkivës Digjitale dhe Menaxhimi i Dokumenteve” me numër të prokurimit:616-25-2487-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Prishtinës më 12/09/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserisht e bazuar ankesa e OE Tretrek SH.P.K.: Botek SH.P.K. me nr. 2025/0692, e datës 25/07/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sistemi i Arkivës Digjitale dhe Menaxhimi i Dokumenteve” me numër të prokurimit: 616-25-2487-2-1-1, (AK) - Komuna e Prishtinës.
2. Mbetët në fuqi, B58Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Komuna Prishtinë, datës, 10.07.2025, për aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1. (një) të vendimit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik OE Tretrek SH.P.K.: Botek SH.P.K., sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.03.2025, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sistemi i Arkivës Digjitale dhe Menaxhimi i Dokumenteve” me numër të prokurimit: 616-25-2487-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës sherbime. Me 15.07.2025 OE Tretëk SH.P.K.: Botëk SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.07.2025 Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25.07.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Tretëk SH.P.K.: Botëk SH.P.K. me nr. 0692/2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sistemi i Arkivës Digjitale dhe Menaxhimi i Dokumenteve” me numër të prokurimit: 616-25-2487-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Tretëk SH.P.K.: Botëk SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet Ankimore Përmes kësaj anekse, atakojmë vendimin e marrë të Autoritetit Kontraktues- Kuvend i Komunës së Prishtinës, mbi refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim. Gjatë shqyrtimit të Kërkesës sonë, AK nuk ka marr parasysh të gjitha pretendimet tona, pra nuk na është përgjigjur/arsyetuar në të gjitha pretendimet tona ashtu sikurse edhe është e obliguar nga LPP dhe rregulloret në fuqi. Në Kërkesën tonë për rishqyrtim, ne kemi përfshirë në total 8 pretendime. Ndërsa AK në vendimin e tyre mbi refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim, vetëm ka ripërsëritur arsyetimin e thukët me të cilin ka eliminuar padrejtësisht ofertën tonë përmes Letrës Standarde për tenderuesin e eliminuar, mirëpo nuk na ka arsyetuar refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim, pavarësisht se me Rregulloren 001/2022, neni 62, paragrafi 2 kërkohet që: Vendimi mbi refuzimin do të arsyetohet dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit. AK nuk merr fare parasysh pretendimet tona, të cilat faktojnë se AK nuk ka bërë një ekzaminim të drejtë të këtij aktiviteti të prokurimit, pavarësisht se procedura e ekzaminimit dhe marrjes së një 4 vendimi për këtë aktivitet të prokurimit ka marr kohë më shumë se sa është e parashikuar me LPP dhe Rregullore (30 ditë nga data e hapjes), ndërsa AK iu desh 66 ditë që të sjellë një vendim. Për të sqaruar dhe njëherë të gjithë rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit, po i shtjellojmë në pika të shkurta të gjitha pretendimet tona apo përgjigjet në pretendimet e AK se oferta jonë është e papërgjegjshme administrativisht, si dhe gjetjet tona pas qasjes në dokumentet e GOE të propozuar për kontratë të cilat vëjnë në dyshim paanshmërinë e AK-së gjatë vlerësimit të tenderëve. 1. Arsyetimi nr 1 i AK-së: Deklarata e grupit të operatorëve ekonomik është e panënshkruar dhe e pavulosur nga OE Botëk shpk. 1. Pretendimi ankimorë - Kërkesa jonë për Rishqyrtim, pika 1: Në lidhje me pretendimin e AK-së të paraqitur në vendim, sipas të cilit “deklarata e grupit të operatorëve ekonomikë është e panënshkruar dhe e pavulosur nga OE BOTEK”, dëshirojmë të sqarojmë se

deklarata në fjalë është dorëzuar si pjesë përbërëse e ofertës sonë, duke përmbushur kështu kërkesën themelore të dosjes së tenderit për ekzistencën e këtij dokumenti. Për më tepër, çdo paqartësi teknike eventuale që mund të lidhet me mungesën e ndonjë nënshkrimi apo vule në këtë dokument nuk mund të konsiderohet si shkelje thelbësore që do të justifikonte eliminimin e ofertës sonë. Në këtë rast, në përputhje me nenin 38 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (të ndryshuar me Nr. 002/2024), Autoriteti Kontraktues ka obligimin që gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të kërkojë sqarime, informacione shtesë apo dokumente plotësuese në rast se dokumentet e dorëzuara paraqesin paqartësi, mangësi jo thelbësore apo kërkojnë qartësim. Kjo dispozitë rregullative përcakton në mënyrë të veçantë, sipas paragrafit 38.5, se: “38.5 Autoriteti Kontraktues mund të ftojë Operatorët Ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE” Kjo do të thotë se kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, përfshirë edhe ato për “kërkesat e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat e grupeve të OE”, të cilat rregullojnë formatin dhe substancën e dokumenteve për grupin e operatorëve ekonomik, hyjnë qartë në kuadër të sferës së dokumenteve që, nëse paraqesin ndonjë paqartësi ose mospërputhje jo thelbësore (p.sh. një mungesë nënshkrimi ose vule), duhej të qartësoheshin ose plotësoheshin përmes një kërkesë për sqarim. Vetëm mungesa totale e dokumentit, që nuk lejon fare verifikimin e kërkesës, mund të përbëjë bazë për eliminim të drejtpërdrejtë. Duke qenë se deklarata në fjalë ekziston dhe është dorëzuar në ofertën tonë, çdo gabim teknik në nënshkrim apo vulë përbën një mospërputhje formale e jo thelbësore dhe duhej të trajtohej konform nenit 38 të Rregullores i mbështetur me nenin 59 të Ligjit të Prokurimit Publik, përmes një kërkesë për sqarim, para se të merrej vendimi për eliminim tonë. 2. Arsyetimi nr 2 i AK-së: Operatori Ekonomik BOTEK ka dorëzuar deklaratën nën betim e nënshkruar nga znj. Donika Potera Pacolli e cila nuk ka autorizim për nënshkrim pasi që nuk është pronare e kompanisë BoteK. 2. Pretendimi Ankimorë - Kërkesa jonë për Rishqyrtim, pika 2: Në lidhje me arsyetimin e AK-së për eliminim të ofertës sonë, ku thuhet se Operatori Ekonomik BOTEK ka dorëzuar deklaratën nën betim të nënshkruar nga znj. Donika Potera-Pacolli, e cila sipas AK nuk ka autorizim për nënshkrim pasi nuk është pronare e kompanisë BOTEK, vlerësojmë se ky veprim nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të KRPP. Konkretisht, sipas nenit 38 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (e ndryshuar me Nr. 002/2024) i mbështetur me nenin 59 të Ligjit të Prokurimit Publik, AK-ja ka për obligim të kërkojë sqarime shtesë ose dokumente plotësuese në rast se ka paqartësi ose mungesë të dokumentacionit të dorëzuar, përpara se të marrë vendim për eliminim të operatorit ekonomik. Në këtë rast, znj. Donika Potera-Pacolli posedon dokument të noterizuar që dëshmon autorizimin përfaqësues për të nënshkruar dhe vepruar në emër të BOTEK në procedurat e prokurimit. Prandaj, 5 AK, në pajtim me dispozitat e sipërpërmendura, ishte dashur të kërkojë sqarime ose të lejojë dorëzimin e dokumentacionit shtesë për të qartësuar këtë çështje, në vend që të marrë vendimin për eliminim të ofertës sonë (oferta më e lirë) pa një hetim të plotë. Gjithashtu, mos nënshkrimi nga pronari i kompanisë, nuk përbën shkelje, e cila do të rezultonte me eliminim të ofertës. E në rastin tonë dokumenti Deklarata nën betim, është nënshkruar nga person me autorizim të noterizuar, dokument ky ekzistues dhe para dorëzimit të ofertës. Për më tepër: Në Opinionin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, pika 14 thekson: "Në pamundësi të nënshkrimit të dokumenteve në fjalë nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik, i njëjti mund të veprojë sipas rregullave mbi autorizimin, të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës." Këtë çështje e përkufizon në mënyrë të qartë Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, konkretisht dispozitat e Kapitullit II – Dispozita plotësuese lidhur me prokurën, të cilat rregullojnë mënyrën dhe vlefshmërinë e autorizimit për

përfaqësim juridik. Prova 1_Autorizimi i noterizuar për përfaqësim, datë 29.11.2024 3. Arsytimi nr 3 i AK-së: Grupi i Operatorëve Ekonomik Tretëk shpk – Botek shpk – Për stafin Besmir Sejdiu, Edmond Jahjaga, Vegim Karacica, Rrezarta Musmurati dhe Lavdije Aliu nuk ka qenë e mundur të verifikohet certifikata, ndërsa për Faik Kurtishin mungon diploma e fakultetit. 3. Pretendimi Ankimorë - Kërkesa jonë për Rishqyrtim, pika 3: Në lidhje me arsyetimin e AK-së se nuk ka qenë e mundur të verifikohen certifikatat për stafin tonë teknik (Besmir Sejdiu, Edmond Jahjaga, Vegim Karacica, Rrezarta Musmurati dhe Lavdije Aliu) si dhe se mungon diploma e z. Faik Kurtishi, ju rikujtojmë se sipas dosjes së tenderit (FTD – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale), në rastet ku është kërkuar CERTIFIKATË, ne kemi ofruar link-un për verifikim online të këtyre certifikatave. Nëse për ndonjë arsye ky verifikim ka rezultuar i pamundur, AK-ja ka pasur për detyrë, në pajtim me nenin 38 të Rregullores Nr. 001/2022 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime shitesë për të qartësuar këtë çështje përpara marrjes së vendimit për eliminim. Gjithashtu, në sqarimin e AK-së të datës 17.04.2025, është sqaruar se “në rastet kur certifikatat nuk kërkojnë, dorëzimi i certifikatave dhe transkripteve nuk është i domosdoshëm”, duke konfirmuar se këto nuk janë elemente të detyrueshme që të shkaktojnë eliminimin tonë automatik. 6 Prova 2_Sqarime shitesë për OE, datë 17.04.2025 Shkeljet e AK-së të gjetura nga ne, pas qasjes në dokumentet e tenderit të dorëzuara nga GOE i propozuar për kontratë (Infosoft shpk & Edusoft shpk) Sqarim me rëndësi: për pretendimet tona të poshtëshënuara, nuk kemi marr asnjë përgjigje nga AK në vendimin e tyre mbi refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim! Prova 3_Vendimi i AK-së, datë 18.07.2025 4. Kërkesa sipas DT: Të gjithë operatorët ekonomikë, përfshirë edhe pjesëtarët e një konsorciumi, duhet të jenë të certifikuar me standardet ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2011 dhe ISO 9001:2015. Pas qasjes në dokumentet e GOE, kemi vërejtur se nga certifikatat e paraqitura nga INFOSOFT System SH.P.K. rezulton se standardi ISO/IEC 27001:2013, me numër certifikate AQS/SI/88982022, ka status “NON VALID – EXPIRED” dhe është shpallur i pavlefshëm përkundër faktit që përmban një datë skadence të mëvonshme, gjë që tregon qartë se certifikata ka humbur vlefshmërinë e saj efektive. Linku për verifikim: <https://www.aqscert.org/> Kodi: AQS/SI/88982022 Prova 4_ISO certifikata e dorëzuar nga GOE i propozuar për kontratë Se OE Infosoft ka dorëzuar më pas certifikatën e riaudituar është në dyshim, pasi që ne këtë fakt e kemi përmendur dhe në Kërkesën për Rishqyrtim, ndërsa AK nuk ka shqyrtuar fare këtë pretendim tonin. 7 5. Kërkesa sipas DT: Operatori ekonomik duhet të ketë së paku dy (2) zhvillues të bazave të të dhënave me së paku pesë (5) vite përvojë në projekte të ngjashme dhe së paku diplomë bachelor në Shkenca Kompjuterike ose fusha të Teknologjisë Informative. Pas qasjes në dokumentet e GOE, kemi vërejtur se stafi i propozuar nga ky GOE nuk i plotëson kërkesat minimale sipas DT, pasi që personi i propozuar për pozitën Zhvillues i bazave të të dhënave - Gazmend H., sipas CV-së së prezentuar përvoja e tij profesionale lidhet me pozitën Software Analyst. Pra nuk ka përvojën e duhur si Zhvillues i bazave të të dhënave. Prova 5_CV_Gazmend H. 6. Kërkesa sipas DT: Operatori ekonomik të ketë së paku një (1) teknik ekspert për çështje sigurie të certifikuar me CompTIA Security+ ose certifikatë ekuivalente, me së paku tri (3) vite përvojë në çështje të sigurisë. Pas qasjes në dokumentet e GOE, kemi vërejtur se stafi i propozuar nga ky GOE nuk i plotëson kërkesat minimale sipas DT, pasi që personi i propozuar për pozitën Teknik ekspert për çështje sigurie – Filip S. është prezentuar diploma e fakulteti e pa përkthyer nga gjuha maqedonase në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë, sikurse kërkohet me LPP- neni 13, paragrafi 4, po ashtu certifikatat e ofruar nuk janë të noterizuar dhe si të tilla, certifikatat e prezentuara janë të paverifikueshme dhe vihet në dyshim autenticiteti i tyre. Prova 5_Diploma_Filip S. dhe certifikimet 7. Kërkesa sipas DT: së paku një (1) eksperti të Menaxhimit të Kualitetit, ndër kërkesat kryesore ishte edhe përvoja profesionale prej minimum pesë (5) viteve në këtë fushë. Pas qasjes në dokumentet e GOE, kemi vërejtur se stafi i propozuar nga ky

GOE nuk i plotëson kërkesat minimale sipas DT, pasi që personi i propozuar për pozitën Ekspert i Menaxhimit të Kualitetit – Berkaj B. sipas të dhënave të prezentuara në CV e tij, nuk përmbush kriterin e përvojës së kërkuar. Përvoja e tij relevante në fushën e testimin dhe menaxhimit të cilësisë është më pak se pesë vite, nga të cilat vetëm një (1) vit rezulton të jetë përvojë e dokumentuar në një kompani të teknologjisë si Inxhinier i Sigurimit të Cilësisë (QA Engineer). Aktivitetet e tjera të përmendura para këtij angazhimi janë kryesisht projekte personale apo freelance, të cilat nuk përbëjnë përvojë të strukturuar dhe të dokumentuar profesionale në menaxhimin e cilësisë, siç kërkohet nga DT. Prova 6 CV Berkaj B. 8. Kërkesa sipas DT: operatorin ekonomik që të disponojë së paku një (1) teknik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e serverëve të ofruar, si dhe së paku një (1) teknik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e storage të ofruar. Pas qasjes në dokumentet e GOE, kemi vërejtur se stafi i propozuar nga ky GOE nuk i plotëson kërkesat minimale sipas DT, pasi që personat e propozuar si Teknik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e serverëve dhe storage të ofruar, nuk posedojnë certifikata të noterizuara. Si të tilla, certifikatat e prezentuara janë të paverifikueshme dhe vihet në dyshim autenticiteti i tyre. Dorëzimi i deklaratave të thjeshta, pa mbështetje me certifikata të noterizuara, nuk mund të konsiderohet provë e mjaftueshme dhe e verifikueshme për të dëshmuar kapacitetin teknik të kërkuar. Përveç kësaj dhe “certifikatat” e dorëzuara nuk përmbushin kërkesën tuaj në DT, pasi që në kërkesën 2.9 të Dosjes së Tenderit, kërkohet që Operatori Ekonomik të ketë së paku një (1) teknik të certifikuar nga prodhuesi për instalimin e serverëve të ofruar, theksojmë se certifikata e paraqitur 8 nga GOE është një “Certificate of Completion”, që tregon vetëm ndjekjen e një kursi/trajnimi dhe nuk përbën një certifikim teknik të lëshuar nga prodhuesi, siç kërkohet nga DT. Gjithashtu, certifikata nuk specifikon qartë që tekniku është i certifikuar për instalimin e serverëve të ofruar, por vetëm në “solution qualification”, që mund të përfshijë trajtime më të përgjithshme ose teorike. Bazuar në këtë, konsiderojmë se kjo dëshmi nuk përmbush kërkesën thelbësore të nenit 2.9 dhe duhet të refuzohet si jo në përputhje me specifikimet teknike të tenderit Prova 8 “Certifikatat” e dorëzuara Ndërkohë konzorciumi ynë, përveç që ka ofertën më të ulët (oferta jonë 168,720.78 EUR, ndërsa e GOE të propozuar për kontratë 195,663.77 EUR), është i përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht. Mirëpo kjo nuk është vlerësuar drejtë nga AK.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30/07/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0692/2025, ndërsa me datë 12/08/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0692 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Tretak SH.P.K.: Botek SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0692 ka vlerësuar si në vijim:

Pergjigjëjet e ekspertit shqyrtues në pretendimet ankimore

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore nga të cilat rrjedhimisht është krijuar shqyrtimi i pretendimeve ankimore, gjatë vlerësimit, ekzaminimit, krahasimin e kriterëve të dosjes së tenderit, përshkrimin e çmimeve, ofertave të prezantuara, më saktësisht ofertën e operatorit ekonomik ankues si dhe oferta e rekomanduar për kontratë, duke analizuar në tërësi raportin e vlersimit, sqarimet, vendimin e autoritetit kontraktues letër standarte dhe dokumentet e kësaj lënde.

Eksperti shqyrtues, pas verifikimit një nga një të dokumenteve lidhur me pretendimin ankimor 1, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) si dhe aktet ligjore sekondare të Rregullores për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), në dokumentacionin e dosjes së tenderit, me theks të veçantë në deklaratën për themelimin e grupit të operatorëve ekonomikë (Aneksi 7), ka konstatuar sa vijon:

Operatori ekonomik ankues, në ofertën e paraqitur, ka dorëzuar deklaratën sipas formës standarde, por e cila është e pa vulosur dhe e panënshkruar. Sipas rregullave për krijimin e aktit juridik për themelimin e grupit, deklarata duhet të përmbajë formën zyrtare të saj, ku specifikisht kërkohet vulosja dhe nënshkrimi, ndër elemente të tjera.

Meqenëse nënshkrimi dhe vulosja përbëjnë element thelbësor nga i cili buron legjitimiteti i dokumentit, mungesa e tij ndikon drejtpërdrejt në vlefshmërinë ligjore të dokumentit. Nënshkrimi, përveçse element i domosdoshëm formal, ka edhe funksion diskualifikues apo kualifikues, varësisht nga rasti - pasi mungesa e tij ose nënshkrimi nga persona të paautorizuar mund të çojë në diskualifikimin e ofertës.

Forma e deklaratës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankues:

Aneksi 7 Deklarata për themelimin e grupit.

Për rrjedhojë, pretendimi ankimor nr. 1, në kuptimin juridiko-administrativ, vlerësohet si i pabazuar.

Eksperti Shqyrtues, lidhur me pretendimin ankimor nr. 2, ku grupi i operatorëve ekonomik ankues kërkon rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës së tij për shkak të nënshkrimit të deklaratës nën betim (Aneks 2) nga personi i autorizuar, si dhe mungesës të autorizimit përkatës të prezantuar bashkë me ofertën, eksperti shqyrtues paraqet sa vijon:

1. Faktet kryesore të konfirmuara

-Autorizimi i noterizuar për përfaqësim nuk është dorëzuar me ofertën në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

-Ankuesi pretendon se dokumenti i autorizimit ekziston dhe mund të ishte dorëzuar, nëse do të ishte kërkuar nga autoriteti kontraktues

2. Analiza ligjore dhe praktike

Neni 72 par. 3 të LPP-së. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Në këtë rast:

-Mungesa e autorizimit të noterizuar për përfaqësimin e nënshkruesit të deklaratës është mangësi thelbësore, jo vetëm procedurale.

-Nënshkrimi i deklaratës nga personi i paautorizuar e bën dokumentin të pavlefshëm dhe rrjedhimisht ofertën jo të pranueshme, sipas praktikës së qëndrueshme të OSHP-së dhe jurisprondencës përkatëse.

3. Vlerësimi i pretendimit ankimorë

Pretendimi në ankesën që Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë sqarime nuk qëndron, pasi:

-Nuk ka pasur paqartësi për t'u sqaruar, por mungesë të dokumentacionit bazik;

-Autorizimi i noterizuar nuk është dorëzuar së bashku me ofertën;

-Sipas standardeve të prokurimit publik, nënshkrimi i dokumenteve nga person i autorizuar është kriter i domosdoshëm për vlefshmërinë e dokumentit.

Sipas ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin ankimor nr. 3 të paraqitur nga operatori ekonomik ankues, sqaron si më poshtë:

Operatori ekonomik ankues, në këtë pretendim, kundërshton vendimin e autoritetit kontraktues për eliminimin e ofertës së tyre. Sipas të dhënave në dosje, autoriteti kontraktues, përmes sqarimeve të datës 17.04.2025, në platformën e-prokurimi ka njoftuar të gjithë operatorët ekonomikë se:

“Në rastet kur certifikatat nuk kërkohen, dorëzimi i tyre së bashku me transkriptet nuk është i domosdoshëm.”

Gjatë trajtimit të këtij pretendimi ankimor dhe pas analizimit të dokumentacionit të ofertës së grupit të operatorëve ekonomik ankues, rezulton se këta kanë prezantuar link për verifikimin e certifikatave dhe dokumentacionit të stafit, por për personelin që është objekt i ankesës, linkët e ofruara nuk kanë qenë funksionale, për rrjedhojë nuk ka qenë e mundur të bëhet verifikimi i tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar për stafin teknik dhe profesional: Besmir Sejdiu, Edmond Jahjaga, Vegim Kovaqica, Rrezarta Musmurati dhe Lavdiye Aliu, rezulton se operatori ekonomik ankues ka dorëzuar diplomat, CV-të dhe certifikatat, ashtu siç janë kërkuar në dosjen e tenderit.

Për çështjen e diplomës së z. Kurtishi

Për diplomën e z. Kurtishi, e cila nuk është prezantuar fare në dokumentacionin e ofertës, vlerësohet se kjo përbën mungesë të një dokumenti thelbësor, pasi ky person është pjesë e stafit që përbën kriter kyç teknik/profesional.

Bazuar në nenin 72, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe i plotësuar), përcaktohet se: “Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenciale të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Për z. Kurtishi, mungesa e diplomës përbën shkelje thelbësore të një kriteri teknik/profesional.

Eksperti shqyrtues për pretendimin ankimor nr. 3 vlerëson se është pjesërisht i bazuar, për shkak se për një pjesë të stafit, dokumentacioni është në rregull dhe i përputhshëm me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pretendimi nr.4.

Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi për standartizimet kodi ISO/SI/88982022, të kërkuara në dosjen e tenderit “FDT”, rreth validitetit të certifikatës, kodi ISO/SI/88982022, konstaton se certifikata e prezantuar në ofertë përmban afat sipas datave, gjë që sipas ekspertit shqyrtues është në rregull dhe se me datën e ofertimit (05.05,2025) certifikata e kontestuar nga OE ankues ka qenë valide dhe e njëjta ka qenë pjesë e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar në kohën e ofertimit.

Andaj, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr.5

Në dosjen e tenderit në FDT është kërkuar:

Eksperti shqyrtues bazuar në verifikimin e dokumentacionit për kandidatin Gazmend H, rezulton se dokumentet e prezantuara (CV-të, diplomat, certifikatat dhe dëshmitë për përvojën e punës) janë paraqitur në gjuhën Maqedonase dhe në gjuhën Angleze dhe janë konform kriterëve të përcaktuara në FTD.

Sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), paragrafi 4, sqaron se, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të dorëzojnë dokumente në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Si rrjedhojë, dokumentet e dorëzuara në gjuhën angleze janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Lidhur me pretendimin ankimor nr.5, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor duke u bazuar në verifikimin e dokumentacionit të atakuar nga operatori ekonomik ankues është i pa

bazuar. Megjithatë, diploma e paraqitur nga Filip S. është në gjuhën Maqedonase e noterizuar, ndersa çertifikatat e prezentuara janë në gjuhën Angleze dhe si rrjedhojë, ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE Tretak SH.P.K.: Botek SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE Tretak SH.P.K.: Botek SH.P.K., janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin pjesërisht konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, por të pamjaftueshme që mund të ndryshojnë vendimin përfundimtarë

te autoritetit kontraktues. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbetet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i datës, 10.07.2025, për shpërblim me kontratë GOE”Infosoft Systems SH.P.K;Edusoft, për aktivitetin e prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Komuna Prishtinë, lidhur aktivitetin e prokurimit “Sistemi i Arkivës Digjitale dhe Menaxhimi i Dokumenteve” me numër të prokurimit: 616-25-2487-2-1-1, (AK) - Komuna e Prishtinë.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0659, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjesërisht të ankesës të OE; Tretak SH.P.K.: Botek SH.P.K.vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Tretak SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: